



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 218, Datë 01.09.2022

MBI

KËRKESËN E SHOQËRISË “BINDI” SH.P.K., PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 170, DATË 26.10.2017

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e”, si dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3, si dhe nenit 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 01.09.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e për gatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1504/1 prot., datë 29.08.2022, “Mbi kërkesën e shoqërisë “BINDI” sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 170, datë 26.10.2017”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “BINDI” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 387, seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 170, datë 26.10.2017, për një afat 5-vjeçar.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1385/3 prot., datë 18.08.2022, ajo ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence.
- Në zbatim të nenit 16, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, i licencuari duhet të paraqesë në ERE një aplikim për rinovim licence jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.
- Aplikimi i shoqërisë “BINDI” sh.p.k. për rinovimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike është paraqitur në afat.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; Dokumentacionin juridik dhe administrativ; Dokumentacionin financiar dhe fiskal; si dhe Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin lidhur me nenin 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; nenin 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”; nenin 9, pika 3, gërmat “a”, “b” dhe “d” si dhe nenin 9, pika 4.8 gërmat “a”, “b” dhe “c”.

Në këtë aplikim mungon dokumenti si më poshtë vijon:

neni 9, pika 3:

- **gërma “c”**: Shoqëria duhet të përcjellë në ERE dhe deklaratën e ortakut të vetëm të saj, ku të jepet miratimi i tij për të mbështetur veprimtarinë e shoqërisë “BINDI” sh.p.k. nëpërmjet të ardhurave të tij personale, sipas kapitalit të deklaruar nga vetë shoqëria.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “BINDI” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 170, datë 26.10.2017.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI